



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**

**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

Procesverbali i dëgjimit publik për Kornizës Afatmesme Buxhetore 2025-2027 në fshatin Lluzhan

Drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani hap dëgjimin publik duke iu uruar mirëseardhje të pranishmëve.

“Jemi në vazhden e dëgjimeve publike të Kornizës Afatmesme Buxhetore, siç e dini edhe ju, Korniza Afatmesme Buxhetore është dokument që i paraprin hartimit të buxhetit për vitin 2025, dhe kjo KAB hartohet mbi bazën e disa limiteve buxhetore të cilat vijnë nga Qarkorja e parë Buxhetore nga Ministria e Financave dhe në kuadër të këtyre limiteve, prioritetive strategjike dhe kërkesave hartohet buxheti, gjithmonë duke i pasur parasysh bashkëbisedimet me qytetarë duke i identifikuar nevojat dhe kërkesat e tyre, për aq sa është e mundur të inkorporohen në buxhetin e vitit 2025, dhe në projeksionet e vitit 2025-2027. Gjithmonë e kemi parasysh që nevojat dhe kërkesat e juaja janë më të mëdha sesa mundësitë buxhetore, por në bazë të limiteve të përcaktuara nga qarkorja do të bëjmë përpjeke për të bërë më të mirën dhe duke i prioritetizuar nevojat e duhura dhe sektoret më të rëndësishme në komunën e Podujevës.

Komuna e Podujevës për vitin 2024, e që realisht jemi në fazën e shpenzimit të buxhetit, realizimit të projekteve, ka një buxhet prej 1 mil 43 mijë euro, ku në bazë të kufinjve buxhetor që kemi marr nga ministria e Financave, Komuna e Podujevës ka një rritje të buxhetit prej afër 2,600.000.00 euro, ku totali do të jetë prej 33,689.115.00 euro, ku nga ky buxhet janë edhe pagat të cilat mbulohen nga arsimit, shëndetësia primare dhe administratës, ku këtu është një vlerë e konsiderueshme buxhetore, ku për këtë vit është 16 mil euro, ku normalisht edhe sipas Ligjit të Pagave kjo vlerë buxhetore do të rritet sepse pagat rriten edhe me rritjen ekonomike dhe kjo rritje do të inkuadrohet në planifikimet buxhetore. Mirëpo përkundër kësaj, ekziston mundësia të kemi një rritje tjetër afër 2 mil euro në investime kapitale, mallra apo në subvencione në të gjitha kategoritë, varësisht nga prioritetet.

Ne sot kemi ardh sot të ju dëgjojmë juve, kërkesat e juaja të ndryshme t'i inkuadrojmë në buxhet për aq sa kemi mundësi buxhetore. Komuna e Podujevës gjatë këtyre viteve iu ka kushtuar vëmendje të veçantë sektorit të Arsimit, Shëndetësisë, Bujqësisë, Kulturës por edhe projekteve infrastrukturore duke filluar nga ndërtimi i rrugëve, trotuareve, kanalizimeve dhe çështje të tjera të cilat janë të nevojshme për qytetarët. Ne çdo kërkesë të juajën do të marrim, qoftë përmes dëgjimeve qoftë në formë të shkruar deri në fund të dëgjimeve të KAB, por edhe deri në hartimin e projektit të vitit 2025 ju gjithmonë do të keni mundësinë të na drejtoheni me kërkesa me qëllim të përfshirjes sa më të madhe të kërkesave, tani fjalën jau kaloj juve që të jepni propozimet e juaja për projektet të cilat duhet të inkuadronen në buxhetin e vitit 2025.

Hasan Stublla- banor i fshatit Lluzhan, kam një kërkesë për drejtorin e Shërbimeve Publike, lidhur me zgjerimin e Podujevë-Prishtinë, të shtëpija ime, mes depos “Shkëlqimi” dhe pompës “Dedës”, aty është një kanalizim i ujërave nga rruga, po më shkakton shumë dëme, sidomos kur ka reshje, Ministria e Infrastrukturës kanë kryer një punë aty, afër 40 m kanë vënë disa gypa por është e pamjaftueshme, kërkesa

ime është të vazhdoni këta gypa të paktën 40-50 m tutje në mënyrë që kur bien shumë shi mos të më dëmtojë brenda në shtëpi, sepse ato ujra janë që mbledhen nga dy anët.

Kryetar i fshatit Sallabajë- kam disa kërkesa të bashkëfshatarëve të mi të fshatit Sallabajë, kohët e fundit aplikimet në subvencione, kriteret e rregullores për tokë të aplikuesit po shkakton problem për aplikuesit, kërkesa tjera kam për infrastrukturë sepse rruga kryesore është e prerë çdo 100 metra, dështoj plani i ujësjellësit, Kedsi ka dëmtu shumë asfaltin, nëse keni mundësi të jepni një shtresë të re, sepse rruga ka dikund rreth 20 vite që është shtruar, sepse gjatësia nuk është e madhe, është rreth 1.5 km, kemi rrugica të pa shtruara, ndriqimi nuk ka përfunduar është në gjysmë.

Sadik Durmishi nga fshati Sallabajë, shqetësimi jem është një kanal, kur e kanë ndërtuar kanalizimin e ri, e kanë mbyll dhe i kanë vendos disa gypa dhe e kanë mbuluar, dhe kur po ka vërshime afër rrugës, shiu që bien na shkakton telashe edhe për të kaluar me veturë, e lëre më këmb, dmth po me vjen keq prej kojshisë afarë dëmsh po i shkakton shiu, ju lutem vizitoheni dhe me 20 metra gyp ky problem eliminohet.

Agon Duraku – banor i fshatit Lupç i Poshtëm, ju përgëzoj për punën që keni bërë deri tani, punën që po bëni tani por mendoj që ka vend ende për të punuar, në fshatin Lupç të Poshtëm kemi trotualet e pa shtruara, një çështje që është shumë me rëndësi janë lumenjtë dhe përrockat, drejtori ka qenë e ka pa gjendjen dhe shpresoj që të ndërmerr dicka, ndërsa telashen më të madhe e kemi kanalizimin, është dëmtuar shumë, është prerë, dhe shumë banor nuk kanë pas mundësi me u lidh dhe në shëndetësi nëse ka mundësi doktori me zgjat orarin sepse nuk jemi të kënaqur, gjithashtu kemi kërkesë edhe për qerdhe.

Hajriz Konushevc - banor i fshatit Llugë. Konushevc ngrit shqetësimin që në lagjen e tyre rreth 10 shtëpi kemi një problem rreth 30 vjeçar, gjatë stinës së vjeshtës dhe pranverës kur niveli i ujit rritet, a ka mundësi me ba drenazh sepse gjatë kësaj periudhe e kemi të pamundur me dal ne oborr, sasia e ujit është shumë e madhe, asnjëherë nuk mundemi me mbjell e me kultivu diçka për shkak se i merr uji kulturat e mbjellura, e këtë vetëm ju mundeni me na ndihmuar me zgjedh.

Banor i fshatit Llugë- lagjia jem u mbet në mëshirën e natyrës, është shtru pak asfalt edhe që sa kohë ka mbet ashtu, nuk ka mundësi me hy me kerre, te prona ime kadastari i komunës së Podujevës ka dal disa herë, por 120 m janë gypat e ujit që hyjnë në kanal por janë shumë të cekta, por ju lutem bejeni një zgjidhje, unë nuk bej problem për tokë, propozoj që sipas mundësive prej kryqit e deri te varrezat me dërguar pak asfalt mes hekurdhës dhe shtëpive.

Zejnullah Ferizi – fshati Majac, kërkesa ime është që nga viti i kaluar për trotuar rreth 300 metër, prej shkollë në Majac janë edhe 100 metër, ata njerëz janë mbet shumë keq, rrugët janë aty pa shtruar, në 3 vende nuk kanë mundësi me u punu se kanë mbet gropa, kur ndahen subvencionet të monitorohet më shumë shpërndarja sepse po keqpërdoren, të njëjtit njerëz i marrin subvencionet disa herë ndërsa të tjerë që e meritojnë jo.

Besim Gërvalla nga fshati Lupç i Poshtëm, fusha e sportit është nis para 3 viteve, është hapur gropa me thellësi 1 metër, a ka mundësi me marr atë fushë me intervenuar e me u ba gati për fëmijë, është një digë në fshat, që para lufte që u ujitke toka, ndërsa tani bëj kërkesë që 2 herë të drejtoria e Bujqësisë me refuzohet, cila është arsyeja ? Vërejtja tjetër është kur po punohet psh , trotuari prej ushtrisë e deri tek

fusha e Sportit është bërë e tmerrshme, uji nuk shkon kurr deri të pjesa tjetër e fshatit, gypat shumë të hollë, dhe nuk ka kurfarë mbikqyrje, përveç kësaj u shemb.

Arbërim Konushevci , meqenëse disa nga kërkesat e fshatit u ngritën nga parafolësit, unë kisha dashtë me ngrit disa tjera, meqenëse janë të mëdha, fillimisht ju falënderoj shumë drejtor Osmani dhe drejtor Selimi për projektet të cilat po realizohen në fshatin tonë e që janë shumë të mirëseardhura për banorët. Një projekt i cili është duke u realizuar është trotuari i fshatit, i cili i ndihmon fëmijët për rrugën për shkollë, por kërkesa është që të punohet ngadalë dhe mirë.

Kërkesa jem është zgjerimi i shtretërve të lumenjve, sepse po kemi shumë problem kur po ka reshje shtëpitë dhe tokat bujqësore po përmbysen (po dëmtohen), i njëjti problem te lumi Llapi edhe kah pjesa e Sibocit, që po i merr uji edhe varrezat, kërkesa tjetër është pjesa e pa asfaltuar te Mulliri, sepse kur po kemi rast vdekje po bëhet shumë e pakalushme, dhe në fund krejt si mësimdhënës i Arsimit, me ba disa shkolla pilot projekt, sidomos shkollën e fshatit tonë, ne e dim që shumë shkolla ngrohen me drunj, dhe e dim që në kohën e furnizimit kur merren tenderet metra e drurit është shumë ë shtrenjt, e realisht çmimi i tyre është shumë më i lirë, pse mos me provu me klima, me energji elektrike, dmth është edhe kursim po edhe ambient me komod për nxënës nëse ngrohen me klima.

Fatlum Osmani- faleminderit të gjithëve për vërejtjet, kërkesat, komentet, ku tani po përpiqem të dha disa përgjigje nga fusha e Arsimit, Bujqësisë, Shëndetësisë dhe Sportit, ndërsa në infrastrukturë do të përgjigjet drejtori i Shërbimeve Publike, Bahri Selimi.

Te çështja e bujqësisë është prioritet te Komuna e Podujevës, bujqësia në të kaluarën i ka pas rreth 400 mijë euro për suveccione, ndërsa tani i kemi 700 mijë euro në vitin 2024, ndërsa për 2025 synojmë të rrisim ende këtë shumë, gjithashtu përveç kësaj ne përmes tejkalimit të hyrave vetanake që kemi patur, jemi në fazën e negociacionit dhe planifikimit të parkut industrial bujqësor në fshatin Sfeçël, i pari i këtij lloji në Kosovë, që gjithashtu synojmë të mos jetë i fundit në llap, ndërsa sa i përket çështjes së digës së ujitjes për toka bujqësore, ka pas kërkesa për largimin e saj, por smund te jap përgjigje, por është një projekt për ndërtimin e liqenit të Pollatës, ku me këtë ndërtim parashihet edhe i sistemit të ujitjes për toka bujqësore një numër të madh të hektarëve, por edhe gjatë këtyre 3 viteve të ardhshme parashohim investimet për ujtijen e tokave bujqësore në kuadër të mundësive buxhetore, ne bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë.

Sa i përket kriterëve për dhënien e suveccioneve në Komunën e Podujevës, ne e kemi një Rregullore për ndarjen e subvencioneve, për çdo thirrje dalin kriteret që derivojnë nga ajo rregullore, nuk është e domosdoshme toka në emer të aplikuesit, por duhet me pas ndonjë parcel që punon tokën, si dëshmi. Te shëndetësia u përmend rritja e shërbimit të mjekut, drejtorja e Shëndetësisë ka statistikat e qarta dhe të sakta për numrin e shërbimeve shëndetësore të cilat ofrohen nëpër lokalitete dhe objekte shëndetsore, ku në bazë të statistikave dhe mundësive do të bëhet menaxhimi i orarit dhe stafit.

Ndërsa sa i përket fushës së Sportit, tani kemi një kontratë aktive për fushat e sportit e cila është në zbatim e sipër, unë po besoj që është i përfshirë në kontratën aktuale. Kërkesa tjetër për qerdhe, ne kemi rritur bukur shumë numrin e qerdheve sepse ka qenë vetëm një qerdhe, ndërsa tani kemi edhe dy qerdhe tjera, në Lluzhan dhe në Sfeçël, pastaj kemi projektet të cilat janë duke u ndërtuar qerdhet në Batllavë, Podujevë dhe jemi duke bërë përpjekje tjera për për ndërtim të qerdheve bazuar ne analizën demografike të lokaliteteve, ku brenda mandatit mendojmë të kemi mbi 10 qerdhe, ku kemi gjetur vetëm 1 qerdhe.

Sa i përket qështjes së ngrohjes, jemi në përpjekje të bërjes së një zgjidhje qoftë me pelet apo pompë termike varësisht sipas mundësive.

Në Arsim në investime kapitale është 16 fishuar buxheti, Në kulturë kemi pasë 5 fishim në fushën e rritjes së subvencioneve, edhe rritje të buxhetit në investime kapitale, kemi një mori të objekteve kulturore të cilat janë bërë siç është, galeria e qytetit, biblioteka, Qendra e Kulturës mirëpo punë kemi ende, kërkesat janë shumë të madhe, por bashkarisht do t'ia dalim të realizojmë projektet më të mira për qytetarët tanë.

Bahri Selimi- drejtor i drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shërbim, falënderon të pranishmit për pyetjet e parashtruara, unë evidentova secilën kërkesë të juajën.

Kanalizimi ishte pyetja e parë, problemi në magjistrale është i identifikuar, mirëpo për shkak të punimeve që po realizohen në rrugë, e dim që rrugët magjistrale dhe regjionale janë kompetencë e Ministrisë së Infrastrukturës, edhe pse infrastruktura nëntokësore është kompetencë e komunës, të mirëmbahet nga komuna, ky problem me gjatësi 40-50 m, besoj që do ta trajtojmë shumë shpejt, besoj që me buxhet të vitit 2024. Kanalizim patëm edhe në Popovë-Majac, ku janë bërë shumë vite më parë, dëmet janë shumë më të mëdha, kemi shumë problem me gypat e vjetër të kanalizimit, po mundohemi me i mirëmbajt e me i sanuar problemet mirëpo kërkesat janë shumë të mëdha, saqë buxheti jonë nuk i përfshin të gjitha, ndërsa sa i përket kanalizimeve të reja ka pak ku nuk janë të kyqur, tash kërkesat janë më shumë individuale sesa kolektive. Të mirëmbajtja e rrugës në Sallabajë, ne kemi intervenuar vitin e kaluar dhe kemi mbyllur gropat, ndërsa shkaktimi i dëmit është prej rrjetit të ujësjellësit, gypat janë vjetruar dhe po rrjedhin ujë, çka po na shkaktojnë telashe dhe prishje të infrastrukturës rrugore. Rrjeti i ujësjellësit është kompetencë e ujësjellësit, dhe është vështirë e kontrollushme kjo çështje, kemi kontratë për mbylljen e gropave, mirëpo këto prishje po janë shumë të shpeshta.

Te ndriqimi publik, kemi problem mirëmbajtjen, ku duhet të fokusohemi te dritat ku po prishen, ku këtë vit ende nuk kemi lidhur kontratë, besoj kah shtatori apo tetori do të jemi me një kontratë për shtrirjen e ndriqimit publik. Në bazë të një analize të vizibilitetit janë 8000 trupa ndriques afër 300 km ndriqim publik, ku edhe komunës ja kanë rritur koston e mirëmbajtjes njëkohësisht edhe shpenzimet e energjisë elektrike e ku arrin rreth 250 mijë euro në vit, janë afër 200 mijë euro mirëmbajtje të ndriqimit publik, ndërsa tani i bie rreth gjysmë milioni që shpenzohet për ndriqim publik.

Sa i përket rregullimit të shtretërve të lumnjve, vitet e fundit jemi përball shumë me vërshime, sidomos në fshatin Llugë siç e cekën edhe banorët e fshatit të pranishëm këtu, është e pamundur për të rregulluar aty ku po dëmtohen ekonomitë familjare dhe kulturat bujqësore, sepse aty ku nuk është e rregulluar pastaj po shpërthen dhe dëmi po rritet, ne si komunë jemi në fazën e projektimit të rregullimit të shtretërve të lumenjve, tash së shpejti fillon projekti, më ndihmën e Ministrisë e cila ka nda një shumë të konsiderushme për projekt po mendojmë gjatë fundvitit të fillojmë rregullimin e shtretërve dhe do të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme, është një problem i cili na ka paraqitur shumë dëme të mëdha, ndërsa sa i përket pyetjes së shtratit të lumit të varrezat e Sibocit, është e planifikuar këtë vit fillojmë, jemi në fazën e lidhjes së kontratës, dhe ky problem do të sanohet këtë vit.

Sa i përket trotuareve, kërkesa është shumë e madhe, mirëpo ne po i orientojmë nga shkollat me qëllim të rritjes së sigurisë së nxënësve për frekuentim të shkollave, në Lupç jemi në fazën e punimeve të trotuarit, ndërsa punime janë duke u kryer edhe në lokalitete, mirëpo problemi jonë është mirëmbajtja sepse po i kushton shumë komunës.

Problemtika tjetër në fshatin Lupç që të dërgon të fusha e sportit, janë problemet pronësore që po na paraqitën në ndërtimin e trotuareve po na detyrojnë të ndërtojmë trotuare në anën e tjetër jo të preferushme, rruga gjithmonë ka një ramje për me i ik uji, ndërsa trotuari duhet me qene në anën e epërme ku nuk mblidhet uji, mirëpo në disa raste për shkak të problemeve me prona po jemi të detyruar të vendosim në anën tjetër.

Një banor i fshatit Llugë - ngrit çështjen e mirëmbajtjes dhe rrethojave të varrezave, është shumë e rëndësishme, a ka mundësi ju me ba dicka si komunë, sepse aty krejt e kemi aty stacionin e fundit.

Bahri Selimi – sa i përket varrezave kemi disa pirojekte që e kemi filluar qe tri vite, mirëmbajtja e varrezave nuk është kompetencë e komunës, është e rregullime me kompani me private nga vet organizimi i fshatit, varrezat tani janë bërë me lagje, jo më me fshatra siç kane qenë më heret, vetëm, në fshatin Obrançë janë 17 parë varreza, ne e kemi të pamundur të sigurojmë rrethoja për varreza, jemi në fazën e fillimit të punës së themelimit të një ndërmarrje publike “Eko Llapi”, ku shpresoj që nga viti i ardhshëm kemi me ja bartë si kompetencë kësaj ndërmarrje dhe ka me i mirëmbajtur varrezat e fshatarve, të qytetit gjithsesi por edhe varrezat e përbashkëta të komplet fshatit. Kemi hartuar një projekt për rregullimin e varrezave të qytetit në fshatin Obrançë, ku ky projekt kushton afër 1. 5 mil vetëm infrastruktura, me një pronë prej 10 hektarësh, ku së shpejti, brenda këtij viti do të fillojmë më punën dhe varrezat e qytetit do të barten në fshatin Obrançë.

Nëse nuk keni pyetje tjera, me kaq e përmbyllim këtë dëgjim publik.



Ju faleminderit për pjesëmarrje, përfundoi drejtori Selimi.

5 Qershor- Podujevë













Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova

Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Lista e pjesëmarrësve të fshatit Lluzhan me rrethinë në dëgjimet e Kornizës Afatmesme  
Buxhetore 2025-2027

	Emri dhe mbiemri	Vendbanimi	Nr.telefonit	Nënshkrimi
1	Ismet Fejzullaha	Sallabaje		
2	HAKIF KOLUSARU	Lluzhë		
3	HAKRIZ KUNOVHANI	Lluzhë		
4	Blazeta Kumbaz	Lluzhë		
5	Anton Stulica	Lluzham		
6	SEFER BUNJAKU	SALLABAJE		
7	SADIK DURMISHI	SALLABAJE		
8	Arbrim Kunovhaci	Lluzhë		
9	Behnam Kunovhaci	Lluzhë		
10	KUSHTRIM CURALI	LLUZHË		
11	EDRESHNIK KEZANI	Lluzhë		
12	BESIM BERVALLA	JUPGË		
13	ZIJUNULLAH FERIZI	MAJAC		
14	HAQIR HURRI	Lluzhë		
15	KATRI ZHITIA	LLUZHË		
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				
25				
26				
27				
28				

29				
30				
31				
32				
33				
34				
35				

**Vërejtje: Njoftohen të gjithë pjesëmarrësit e takimit se të dhënat e listës së nënshkrimeve dhe fotot përdoren për postime në faqen zyrtare të Komunës së Podujevës!**

Podujevë

05.06.2024